

KËRKESE PËR INFORMACION

Emër Mbiemër: Z./Znj. Vivian Mançellari	Adresa postare: Rr. "Qemal Stafa" 92, Tiranë, 1057 Adresa elektronike: vivianmancellari@yahoo.com Nr. Tel: +355693945006	Data: 06/12/2024 Nënshkrimi: 
---	---	--

Autoriteti Publik : Bashkia Pukë
Adresa: Sheshi Tërbuni, SH5, Pukë
Qyteti: Pukë

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

1. Sa dhoma për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin janë ngritur në bashkinë tuaj dhe ku ndodhen ato?
2. A ka pasur investime për përmirësimin e infrastrukturave që ofrojnë masat alternative për të mitur në bashkinë tuaj? Ku është investuar dhe sa?
3. Sa të mitur në konflikt me ligjin kanë marrë masa alternative në bashkinë tuaj, për çdo vit, nga firmosja e marrëveshjes me Ministrinë e Drejtësisë në 2018 deri me 2024, duke përfshirë ata që janë nën 14 vjeç dhe ata që janë rikthyer në sistemin e drejtësisë penale?
4. Sa qendra multifunkionale ka kjo bashki dhe ku ndodhen ato?
5. Sa nga qendrat multifunkionale janë adaptuar pas firmosjes së marrëveshjes për të ofruar shërbime për të miturit në konflikt me ligjin, për rehabilitim, mbikëqyrje dhe edukim?
6. Sa janë kostot e investuara nga bashkia për riadaptimin e këtyre qendrave multifunkionale nga firmosja e marrëveshjes, deri më 2024 për çdo vit?
7. Çfarë lloj shërbimesh ofrohen në këto qendra për të miturit, përfshirë mbështetje psikosociale, arsimore dhe rehabilituese?
8. Sa punonjës social të trajnuar për të ndjekur të miturit në konflikt me ligjin ka bashkia juaj në 2024?
9. Sa të mitur janë dënuar me burgim në Bashkinë Pukë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative nga firmosja e marrëveshjes deri më 2024, për çdo vit?
10. Sa të mitur nën 14 vjeç janë dënuar me burgim në Bashkinë Pukë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative?
11. Sa të mitur në konflikt me ligjin nën 14 vjeç janë ndjekur nga punonjës socialë dhe sa janë të përfshirë në programet e mbikëqyrjes dhe rehabilitimit në bashkinë tuaj?
12. Sa janë të miturit që kanë ndjekur programet e rehabilitimit pas përfundimit të dënimit dhe sa të mitur nga bashkia juaj janë recidivist?
13. A keni akses në databazën kombëtare për ndjekjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin?
14. Si komunikon me databazën kombëtare për të miturit në konflikt me ligjin bashkia Pukë?
15. Sa raste të të miturve në konflikt me ligjin janë regjistruar në bashkinë tuaj në 5 vitet e fundit?
16. A ka bashkia juaj një sistem të vetin për monitorimin e masave alternative për të miturit në konflikt me ligjin?
17. Cilat projekte janë realizuar që nga firmosja e marrëveshjeve për drejtësinë alternative për të miturit? Sa kanë qenë kostot e investuara dhe a janë akoma funksionale?
18. Sa fonde janë alokuar nga buxheti i bashkisë për zbatimin e këtyre projekteve?
19. Sa të mitur kanë kryer masa alternative në bashkinë tuaj që prej vitit 2018 për çdo vit?
20. Sa efektiv është komunikimi mes njësisë administrative të bashkisë dhe qendrave multifunkionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të mitur?

21. Sa raste nga firmosja e marrëveshjes nga bashkia juaj deri më sot janë transferuar nga njësi bashkiake drejtë qendrave multifunksionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të miturit?

Të tjera të dhëna

Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:

Informacioni kërkohet në formë elektronike.

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/2024

Numri rendor i kërkesës:

Komente: _____

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al, [portalit pyetshtetin.al](http://portalit.pyetshtetin.al) apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Ju mund të dërgoni një kërkesë edhe nëpërmjet portalit pyetshtetin.al
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.